



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.389-3/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët– Skender Çoçaj kryesues, Bujar Muzaqi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 27.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.389/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i me datë 04.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.389/2025, nga Avni Gashi kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Istog, i cili pretendon se në disa vendvotime janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, përkatësisht në këto vendvotime: SH.F.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë, VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në VV 0602, dhe SH.F.M.U “Trepça” në Banjë të Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë.

Sipas parashtruesit të ankesës në rezultatet përfundimtare për asamble komunale në Istog, kandidati nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, rezulton të ketë marrë 197 vota. Ndërsa sipas gjendjes faktike që është paraqitur në rezultatet e shpallura nga KQZ, si rezultate përfundimtarë për Asamble Komunale në Istog, rezulton që në disa qendra votimi dhe vendvotime, i njëjti ka më pak vota edhe pse votuesit e tij, kanë deklaruar me shkrim që kanë votuar në këto vendvotime dhe se në bazë të deklaratave të tyre, numri i votave do të duhej të ishte më i madh.

Sipas parashtruesit të ankesës në Qendrën e votimit Shkolla Fillore “Hysni Zajmi” në Vrellë: Vendvotimi 0606/03 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 21 vota, kurse i njëjti posedon 26 deklaratat të votuesve të cilët pohojnë se kanë votuar numrin 5, po ashtu në Vendvotimin 0606/04, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 10 vota, kurse i

njëjti posedon gjithsej 18 deklarata të votuesve, në Vendvotimin 0606/05, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 44 vota, ndërsa deklarata e komisionerit të AAK-së Sadeta Vuthaj dhe deklarata nga Vëzhguesi i LDK-se Hamdi Zeqiraj, i njëjti pretendon se ka marrë 50 vota.

Në Qendrën e votimit 0602, SH,.F.M.U "Trepça" Banjë e Pejës, në Vendvotimin 0602/02, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara 0 vota, kurse sipas deklaratës në këtë vendvotim duhet të ketë 1 votë. Në Vendvotimin 0602/03, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 0 (zero) vota, kurse sipas deklaratave duhet ti ketë 2 vota. Në vendvotimin 0602/05, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 6 vota, kurse sipas deklaratave duhet të ketë 7 vota. Në vendvotimin 0602/06, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 3 vota, kurse i njëjti duhet ti ketë 6 vota. Në vendvotimin 0602/07, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuar gjithsejtë 2 vota, kurse i njëjti duhet ti ketë 3 vota.

Më tej në ankesë pretendon se nga votimi me postë sipas rezultateve nga KQZ janë publikuar gjithsej 14 vota, kurse sipas dëshmisë së familjarëve dhe miqve i njëjti ka gjithsejtë 21 vota në total: 9 familjar/miq nga Gjermania, 6 familjar/miq nga Zvicra, 5 familjar/miq nga Austria, 1 mik nga Brukseli. Si provë në ankesë ka bashkangjitur deklarata të votuesve dhe komisionerëve, kërkon që të bëhet rinumërimi i votave.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, NI-.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, gjithashtu ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024,

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Më tej në përgjigje theksohet se më datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. (Shih të bashkangjitur Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime). Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 1 7, Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr.14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike,

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese i cili mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar dëshmi të çarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LPZ-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, dhe pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marr më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj. Pra, nuk ka bashkëngjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e saj.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

PZAP, pas shqyrtimit të kësaj ankese, me vendimin ZL.A.nr.389/2025 të datës 05.11.2025, ka refuzuar ankesën e Avni Gashi, kandidat për asamble komunale në Komunën e Istogut, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.111/2025 të datës 11.11.2025, ka aprovuar ankesën e Avni Gashi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik AAK, Komuna Istog, dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.389/2025 të datës 05.11.2025, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit Avni Gashi, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, në aktvendimin A.A.nr.111/2025 i datës 11.11.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në procedurë të rivendosjes refuzoi ankesën si të pabazuar.

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin A.A.nr.120/2025 të datës 19.11.2025, ka aprovuar ankesën e Avni Gashi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik AAK, Komuna Istog, dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.389-2/2025 të datës 14.11.2025, dhe çështjen e ka kthyer përsëri në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të ankuesit Avni Gashi, duke vepruar edhe sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës, PZAP-i mbledhi dhe i hetoi prova, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat nga shkresat e lëndës, dhe nga gjitha shkresat dhe provat e mbledhura gjatë hetimit të bërë në QNR ku janë hapur kutitë e votimit sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme dhe erdhi në përfundim se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, si dhe hetimeve të kryera nga ekipi hetues në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, vlerësoj se pretendimet ankimore të kandidatit për Asamble Komunale nga subjekti politik i AAK Avni Gashi dega Istog, janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, as pas hetimeve të bëra nga PZAP nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullësi në qendra të votimit të cekura në ankesë dhe nga fletëvotimet e arritura me postë.

Paneli për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar, ka ndërmarrë hetim ashtu që më datë 12.11.2025 ka kërkuar nga KQZ, materialin zgjedhor lidhur me pretendimet ankimore të kandidatit Avni Gashi, dhe se njëjta ka siguruar materialin: Formularët e Rezultateve për kandidat, Librin e Votimit (Libri i shënimeve në vendvotim), si dhe Librin e Evidencës në QNR. Mirëpo, nga provat e siguruara paneli nuk mundi të vërtetoj ndonjë parregullsi apo vërejtje gjatë votimit, numërimit apo mos regjistrim të votës, si dhe nga fletëvotimet e arritura me postë, pasi që nuk ka mospërputhshmëri të rezultateve.

Me datën 24.11.2025, PZAP-i, ka zhvilluar hetime në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, në QV SH.F.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë, VV 0606/03, VV 0606/04 VV 0606/05, si dhe në QV 0602, në QV SH.F.M.U “Trepça” në Banjë të Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë.

PZAP me rastin e hetimeve ka hapur kutitë në vendvotimet e lartpërmendura, ka verifikuar se sa vota gjenden në kutitë e votimit për ankuesin Avni Gashi, po ashtu ka bërë hetimin në Librin e Votimit, në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve, si dhe hetimin e fletëvotimeve të votuesve përmes postes.

Nga verifikimet/hetimet e bëra në fletëvotimet në kutitë e votimit dhe nga verifikimet në Formularët e Rezultatit të Kandidatëve, PZAP ka konstatuar të gjeturat si në vijim:

Në QV SH.F.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë,

Në kutinë e votimit VV 0606/03, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 23 vota, ndërsa në rezultatin e publikuar nga KQZ, i njëjti ka 21 vota

Në kutinë e votimit VV 0606/04, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 10 vota,

Në kutinë e votimit VV 0606/05, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 44 vota

Në QV 0602, SH.F.M.U “Trepça” në Banjë të Pejës,

Në kutinë e votimit VV 0602/02, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 0 vota

Në kutinë e votimit VV 0602/03, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 0 vota

Në kutinë e votimit VV 0602/05, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 6 vota

Në kutinë e votimit VV 0602/06, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 3 vota

Në kutinë e votimit VV 0602/07, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 2 vota

Ndërsa në kutinë e votimit VP06/06, tek votat me postë, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 2 vota, në rezultatet e publikuara nga KQZ-ja, ka 14 vota, ndërsa në pretendimet ankimore i njëjti thekson se i posedon 21 vota.

Pra PZAP pas hapjes së kutive të votimit në QNR në vendvotimet e paraqitura në ankesë nga parashtruesi i ankesës rezulton se ka gjetur 90 vota të kandidatit-parashtruesit të ankesës Avni Gashi, pra pretendimet e parashtruesit të ankesës janë në tërësi të pa bazuara.

Nga verifikimet/hetimet e bëra në Librat e Votimit në vendvotimet e lartcekura ekipi i PZAP-it, ka konstatuar të gjeturat si:

Procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, gjatë hetimit në QNR, PZAP, nuk ka vërejtur asnjë parregullsi të evidentuar nga komisionarët në vendvotim, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit- kandidatit Avni Gashi, nga radhët e subjektit politik AAK-Istog.

Pretendimi ankimor i kandidatit nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, Avni Gashi, se i njëjti ka fituar 197 vota, dhe se nuk i janë regjistruar votat tjera të familjareve të tij, të cilët kanë votuar në këto qendra, për çka ka bashkangjitur edhe prova – deklarata, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që nga provat e ofruara nuk është arritur të vërtetohen pretendimet e tij ankimore, se në këto qendra të votimit kanë votuar familjarët e tij, njeherit PZAP, pas hetimit të bërë në QNR, ka konstatuar se i njëjti të ketë marrë 90 vota, në vendvotimet për të cilat i ka paraqitur në ankesë, dhe se këto vota nuk mund të dihet se nga cili votues është votuar.

Paneli pas hetimeve të kryera në këtë rast, ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës nuk ka sjell prova që vërtetojnë pretendimet ankimore, ndërsa provat e bashkangjitura në ankesë dhe atë disa deklarata të votueseve të tij të cilët kanë deklaruar me shkrim që kanë votuar në këto vendvotime të njëjtat nuk janë prova të sigurt dhe të besueshme pasi që nga përmbajtja e tyre vërehet qartë se të gjitha ato janë disa formular identik të plotësuar me të dhëna personale të disa personave dhe se këto prova nuk e identifikojnë se për cilin kandidat kanë votuar personat të cilët kanë nënshkruar këto deklarata, prandaj edhe nuk mund të vërtetohet se personat e apostrofuar që kanë dhënë deklarate kanë votuar për kandidatin Avni Gashi, pra asnjë fletëvotim nuk e identifikon votuesin duke qenë se votimi është i fshehtë

Paneli ka vlerësuar si të pabazuara edhe pretendimet ankimore të ankuesit se në vendvotimet e sipërcituara si më lartë i janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, ngase numërimi për kandidatët asambleist bëhet në mënyrë transparente vetëm në Qendrën Komunale të Numërimit, ashtu siç është paraparë me nenin 15 dhe 16 dhe 17 të Rregullores Zgjedhore 16/2024 dhe Procedurës së paraparë të Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për zgjedhjet Lokale 2025, numërimi bëhet në Qendrën e Numërimit duke kaluar nëpërmes sistemit digjital, ku më këtë rast çdo fletëvotim në të dy anët shfaqet në ekran të cilën e shohin të gjithë personat e pranishëm, komisionarët, vëzhguesit e subjekteve politike dhe mediat e akredituara ku dhe mund të bëhen vërejtje lidhur me votat nëse duhet të konsiderohet e vlefshme apo jo. Po ashtu PZAP, pas hetimit të kryer nuk ka gjetur asnjë vërejtje apo kundërshtim apo mos regjistrim të votave, në vendvotimet SH.F.M.U “Hysni

Zajmi” në Vrellë, Librin e Votimit dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotime: VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në QV 0602, SH.F.M.U “Trepça” në Banjë të Pejës, Librin e Votimit dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotimet VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë VP06/07 Libri i Evidencës në QNR.

Duhet cekur se lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: *”deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit”*.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerësoj se bazuar në nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: *”Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Sipas kësaj dispozite ligjore parashtruesi i ankesës duhet të sjell dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij, por që me rastin e parashtrimin të ankesës nga Avni Gashi, kandidati për asamblë komunale i subjektit politik AAK, nuk ka sjell dëshmi që vërtetohen pretendimet e tij, ndërsa pretendimet e tilla nuk kanë gjete mbështetje edhe pas hetimit dhe provave të siguruara nga PZAP, andaj pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore.

Andaj Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla të ankuesit janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se këto pretendimet më shume paraqitën si pritshmëri të ankuesit për më shumë vota, e jo që në realitet ka pasur mungesë të votave.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *”PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *”PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*, andaj vlerësoj se ankesa e lartë përmendur nuk është e bazuar dhe të njëjtën vendosi që ta refuzoj si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.389-3/2025 më datën 27.11.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.126/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi, kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Muhamet Rexha, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së ankuesit: Avni Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.389-3/2025, të datës 27.11.2025, në seancën e mbajtur më datë 03.12.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga ankuesi: Avni Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.389-3/2025, të datës 27.11.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.389-3/2025, të datës 27.11.2025, është vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.389/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Avni Gashi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr. 01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

Kundër këtij vendimi ankesë në Gjykatën Supreme, ka parashtruar Avni Gashi, kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik: Aleanca për



Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e LZP-së, shkelje të së drejtës materiale, dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovojë ankesën si të bazuar, dhe të anuloj vendimin e PZAP ZL.Anr.389-3/2025, të datës 27.11.2025.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e parashtruar nga kandidati për kuvend komunale në Komunën e Istogut, Avni Gashi, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar i PZAP-it, ZL.Anr.389-3/2025, të datës 27.11.2025, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 04.11.2025, PZAP ka pranuar ankesën ZL.Anr.389/2025, nga Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Istog, i cili pretendon se në disa vendvotime janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, përkatësisht në këto vendvotime: SH.F.M.U. "Hysni Zajmi" në Vrellë, VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në VV 0602, dhe SH.F.M.U. "Trepça" në Banjë të Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë.

Sipas parashtruesit të ankesës, në rezultatet përfundimtare për asamble komunale në Istog, kandidati nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, rezulton të ketë marrë 197 vota. Ndërsa sipas gjendjes faktike që është paraqitur në rezultatet e shpallura nga KQZ, si rezultate përfundimtare për Asamble Komunale në Istog, rezulton që në disa qendra votimi dhe vendvotime, i njëjti ka më pak vota, edhe pse votuesit e tij kanë deklaruar me shkrim që kanë votuar në këto vendvotime dhe se, në bazë të deklaratave të tyre, numri i votave do të duhej të ishte më i madh.

Sipas parashtruesit të ankesës, në Qendrën e Votimit Shkolla Filllore "Hysni Zajmi" në Vrellë: në vendvotimin 0606/03 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsej 21 vota, kurse i njëjti posedon 26 deklarata të votuesve të cilët pohojnë se kanë votuar numrin 5. Po ashtu, në



vendvotimin 0606/04 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsej 10 vota, kurse i njëjti posedon gjithsej 18 deklarata të votuesve. Në vendvotimin 0606/05 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsej 44 vota, ndërsa sipas deklaratës së komisioneres së AAK-së, Sadeta Vuthaj, dhe deklaratës nga vëzhguesi i LDK-së, Hamdi Zeqiraj, i njëjti pretendon se ka marrë 50 vota.

Në Qendrën e votimit 0602, SH.F.M.U. "Trepça", Banjë e Pejës, në vendvotimin 0602/02, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara 0 vota, kurse sipas deklaratës në këtë vendvotim duhet të ketë 1 votë. Në vendvotimin 0602/03 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsej 0 (zero) vota, kurse sipas deklaratave duhet t'i ketë 2 vota. Në vendvotimin 0602/05 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsej 6 vota, kurse sipas deklaratave duhet të ketë 7 vota. Në vendvotimin 0602/06, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsej 3 vota, kurse i njëjti duhet t'i ketë 6 vota. Në vendvotimin 0602/07, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsej 2 vota, kurse i njëjti duhet t'i ketë 3 vota.

Më tej, në ankesë pretendon se nga votimi me postë, sipas rezultateve nga KQZ, janë publikuar gjithsej 14 vota, kurse sipas deklarimeve të familjarëve dhe miqve, i njëjti ka gjithsej 21 vota, në total: 9 familjarë/miq nga Gjermania, 6 familjarë/miq nga Zvicra, 5 familjarë/miq nga Austria, 1 mik nga Brukseli. Si provë në ankesë ka bashkangjitur deklarata të votuesve dhe komisionerëve, kërkon që të bëhet rinumërimi i votave.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), dhe Procedurën e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, NI.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2024, neni 9 paragrafi 1 thekson se: në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilitdo VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ gjithashtu njofton se procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe



Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve, ka vepruar në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Më tej, në përgjigje theksohet se më datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, përfshirë pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfëve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve që kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve (shih të bashkangjitur Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime).

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR; përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore, si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar, por sipas tij, mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, si dhe në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese, i cili mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave dhe familjarëve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4, paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse, në kuptim të nenit 117, paragrafi 3 të LPZ-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë provë



konkrete, por janë supozime, sepse pritshmëritë e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkuptojnë se ka mospërputhje të rezultatit. Gjithashtu, llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara. Në kuptim të nenit 117, paragrafi 3 të LPZ-së, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij. Pra, nuk ka bashkëngjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e saj.

KQZ në fund thekson se i gjithë materiali zgjedhor (duke përfshirë kamerat e sigurisë, librat e votimit dhe formularët) gjendet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

PZAP, në rivendosje sipas ankesës së ankuesit Avni Gashi, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktvendimin A.A.nr.120/2025 të datës 19.11.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, i mbledhi, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat nga shkresat e lëndës, dhe nga të gjitha shkresat dhe provat e mbledhura gjatë hetimit të bërë në QNR, ku janë hapur kutitë e votimit sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme, erdhi në përfundim se:

Ankesa është e pabazuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, si dhe hetimeve të kryera nga ekipi hetues në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, vlerësoi se pretendimet ankimore të kandidatit për Asamble Komunale nga subjekti politik AAK, Avni Gashi, dega Istog, janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara dhe, si të tilla, i refuzoi për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, as pas hetimeve të bëra nga PZAP nuk është arritur të vërtetohet se ka pasur parregullësi në qendrat e votimit të cekura në ankesë dhe nga fletëvotimet e arritura me postë.

Paneli, për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar, ka ndërmarrë hetim, ashtu që më datë 12.11.2025 ka kërkuar nga KQZ materialin zgjedhor lidhur me pretendimet ankimore të kandidatit Avni Gashi, dhe KQZ-ja ka siguruar materialin: Formularët e Rezultateve për Kandidat, Librin e Votimit (Libri i shënimeve në vendvotim), si dhe Librin e Evidencës në



QNR. Mirëpo, nga provat e siguruara, paneli nuk mundi të vërtetojë ndonjë parregullsi apo vërejtje gjatë votimit, numërimit apo mosregjistrimit të votës, si dhe nga fletëvotimet e ardhura me postë, pasi nuk ka mospërputhshmëri të rezultateve.

Më datën 24.11.2025, PZAP-i ka zhvilluar hetime në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, në QV SH.F.M.U. "Hysni Zajmi" në Vrellë, VV 0606/03, VV 0606/04, VV 0606/05, si dhe në QV 0602, në QV SH.F.M.U. "Trepça" në Banjë të Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07, si dhe votat me postë. PZAP, me rastin e hetimeve, ka hapur kutitë në vendvotimet e lartpërmendura, ka verifikuar sa vota gjenden në kutitë e votimit për ankuesin Avni Gashi, po ashtu ka bërë hetimin në Librin e Votimit, në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve, si dhe hetimin e fletëvotimeve të votuesve përmes postës.

Nga verifikimet dhe hetimet e bëra në fletëvotimet në kutitë e votimit dhe nga verifikimet në Formularët e Resultatit të Kandidatëve, PZAP ka konstatuar të gjeturat si në vijim: Në QV SH.F.M.U. "Hysni Zajmi" në Vrellë: Në kutinë e votimit VV 0606/03 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 23 vota, ndërsa në rezultatin e publikuar nga KQZ, i njëjti ka 21 vota. Në kutinë e votimit VV 0606/04 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 10 vota. Në kutinë e votimit VV 0606/05 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 44 vota. Në QV 0602, SH.F.M.U. "Trepça" në Banjë të Pejës: Në kutinë e votimit VV 0602/02 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 0 vota. Në kutinë e votimit VV 0602/03 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 0 vota. Në kutinë e votimit VV 0602/05 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 6 vota. Në kutinë e votimit VV 0602/06 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 3 vota. Në kutinë e votimit VV 0602/07 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 2 vota. Në kutinë e votimit VP06/06, tek votat me postë, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 2 vota, ndërsa në rezultatet e publikuara nga KQZ-ja ka 14 vota, dhe në pretendimet ankimore i njëjti thekson se i posedon 21 vota.

Pra, PZAP, pas hapjes së kutive të votimit në QNR në vendvotimet e paraqitura në ankesë nga parashtruesi i ankesës, ka konstatuar se ka qenë 90 vota për kandidatin-parashtrues të ankesës, Avni Gashi. Pra, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë në tërësi të pabazuara. Nga verifikimet dhe hetimet e bëra në Librat e Votimit në vendvotimet e lartpërmendura, ekipi i PZAP-it ka konstatuar të gjeturat si vijon: Procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, gjatë hetimit në QNR, PZAP nuk ka vërejtur asnjë parregullsi të evidentuar nga komisionarët në vendvotim, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit – kandidatit Avni Gashi, nga radhët e subjektit politik AAK – Istog.



Pretendimi ankimor i kandidatit nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, Avni Gashi, se i njëjti ka fituar 197 vota dhe se nuk i janë regjistruar votat e tjera të familjarëve të tij që kanë votuar në këto qendra, për të cilat ka bashkangjitur edhe prova - deklarata, është i pabazuar. Nga provat e ofruara nuk është arritur të vërtetohen pretendimet e tij ankimore se në këto qendra të votimit kanë votuar familjarët e tij. Njëherit, PZAP, pas hetimit të bërë në QNR, ka konstatuar se i njëjti ka marrë 90 vota në vendvotimet për të cilat i ka paraqitur në ankesë, dhe se këto vota nuk mund të dihet nga cili votues janë dhënë.

Paneli, pas hetimeve të kryera në këtë rast, ka vlerësuar se parashtuesi i ankesës nuk ka sjellë prova që vërtetojnë pretendimet ankimore, ndërsa provat e bashkangjitura në ankesë dhe disa deklarata të votuesve të tij, të cilët kanë deklaruar me shkrim se kanë votuar në këto vendvotime, nuk janë prova të sigurta dhe të besueshme. Nga përmbajtja e tyre vërehet qartë se të gjitha janë disa formularë identik të plotësuar me të dhëna personale të disa personave dhe se këto prova nuk e identifikojnë për cilin kandidat kanë votuar personat që i kanë nënshkruar deklaratat. Prandaj, nuk mund të vërtetohet se personat e apostrofuat që kanë dhënë deklarata kanë votuar për kandidatin Avni Gashi, pasi asnjë fletëvotim nuk e identifikon votuesin, duke qenë se votimi është i fshehtë.

Paneli ka vlerësuar si të pabazuara edhe pretendimet ankimore të ankuesit se në vendvotimet e sipërpërmendura si më lartë i janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, ngase numërimi për kandidatët e asamblesë bëhet në mënyrë transparente vetëm në Qendrën Komunale të Numërimit, ashtu si është paraparë me nenet 15, 16 dhe 17 të Rregullores Zgjedhore 16/2024 dhe Procedurës së paraparë të Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025. Numërimi bëhet në Qendrën e Numërimit duke kaluar nëpër sistemin digjital, ku në këtë rast çdo fletëvotim shfaqet në të dy anët në ekran, të cilin e shohin të gjithë personat e pranishëm, komisionarët, vëzhguesit e subjekteve politike dhe mediat e akredituara, ku mund të bëhen vërejtje lidhur me votat nëse duhet të konsiderohet e vlefshme apo jo.

Po ashtu, PZAP, pas hetimit të kryer, nuk ka gjetur asnjë vërejtje apo kundërshtim apo mos regjistrim të votave në vendvotimet SH.F.M.U. "Hysni Zajmi" në Vrellë, në Librin e Votimit dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotimet VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në QV 0602, SH.F.M.U. "Trepça" në Banjë të Pejës, në Librin e Votimit



dhe në Formularët e Rezultateve për kandidat në vendvotimet VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07, si dhe tek votat me postë VP06/07, Libri i Evidencës në QNR.

Duhet cekur se, lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësinë e votimit, është krijuar tashmë praktikë gjyqësore, pasi Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025, të datës 24.03.2025, kishte konstatuar se: *“Deklaratat e votuesve të cilët pretendonin se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara, për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesi përkatës ka votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar, për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit.”*

Bazuar në të lartheksuarat, paneli vlerësoi se, bazuar në nenin 117, paragrafi 3 të LZP-së, përcaktohet se: Vendosja për ankesën nga PZAP-ja mbështetet në “dëshmi të qarta dhe bindëse”. Sipas kësaj dispozite ligjore, parashtruesi i ankesës duhet të sjellë dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij, por me rastin e parashtrimin të ankesës nga Avni Gashi, kandidati për assemble komunale i subjektit politik AAK, nuk ka sjellë dëshmi që vërtetojnë pretendimet e tij. Ndërsa pretendimet e tilla nuk kanë gjetur mbështetje edhe pas hetimit dhe provave të siguruara nga PZAP, andaj pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla të ankuesit janë të paargumentuara dhe të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se këto pretendime më shumë paraqiten si pritshmëri të ankuesit për më shumë vota, e jo se në realitet ka pasur mungesë të votave.

Bazuar në arsyet e sipërsëhënuara dhe në kuptim të nenit 118, paragrafi 1 të LZP-së, i cili parasheh se *“PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”*, dhe nenit 13, paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i mund në përgjithësi të refuzojë një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste primafacie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*, paneli vlerësoi se ankesa e lartpërmendur nuk është e bazuar dhe vendosi ta refuzojë si në dispozitiv të këtij vendimi. Nga arsyet e theksuara më lart, duke u bazuar në nenin 117, paragrafi 3 dhe nenin 118, paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të saj.



Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 04.11.2025, të parashtruar nga Avni Gashi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut, nga subjekti politik: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të cilat mutatis mutandis vlejnë edhe për zgjedhjet lokale përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të këtij ligji.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, andaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve të ankuesit dhe shkresave në dosjen e lëndës, përkatësisht procesverbalet e hetimit të materialit zgjedhor, vlerëson se PZAP sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, të dhëna në aktvendimin AA.nr.120/2025, të datës 19.11.2025, zhvilloi hetimin e kutive të votimit, sipas qendrave kontestuese, ashtu që: u hapën kutitë e votimit në vendvotimet e kontestuara, u kontrolluan dhe u numëruan votat për kandidatin Avni Gashi në kutitë e votimit, u shqyrtuan Librat e Votimit dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve, si dhe fletëvotimet e dërguara me postë.

Në procedurën e hetimit, me rastin e hapjes dhe verifikimit të kutive në qendrat e numërimit për vendvotimet e paraqitura në ankesë, rezultoi se kandidati Avni Gashi kishte 90 (nëntëdhjetë) vota në total. Poashtu, u konstatua se: nuk janë vërejtur parregullsi gjatë procesit të votimit apo numërimit, asnjë votë nuk rezultoi e pa-regjistruar, të gjitha rezultatet në QNR përputheshin me formularët dhe librat e vendvotimeve.



Gjykata kishte parasysh se në procedurën e rivendosur si dhe pas hetimit u konstatua se kishte një mospërputhje në vendvotimin në QV SH.F.M.U. “Hysni Zajmi” në Vrellë, përkatësisht se në kutinë e votimit VV 0606/03 rezulton që kandidati Avni Gashi ka 23 vota, ndërsa në rezultatin e publikuar nga KQZ, i njëjti ka 21 vota, si dhe tek votat me postë, në kutinë e votimit VP06/06, rezulton që kandidati Avni Gashi ka 2 vota, ndërsa në rezultatet e publikuara nga KQZ-ja ka 14 vota, megjithatë gjykata vlerëson se të njëjtat nuk kanë ndonjë ndikim në ndryshimin e gjendjes faktike andaj si të tilla refuzohen si të pabazuara. Gjykata Supreme vlerëson se PZAP-i ka vepruar konform sygjërimeve të Gjykatës Supreme për zhvillim të hetimeve në kutitë e votimeve dhe gjatë hetimeve nuk ka dispozitë konkrete që sanksionon pjesëmarrjen e ankuesit në atë procedurë, andaj në këtë drejtim nuk janë gjetur shkelje.

Lidhur me pretendimet e ankuesit se familjarët e tij kanë votuar për të, por votat mungojnë, gjykata vlerëson se tani në këtë fazë pas hetimit të materialit zgjedhor dhe konstatimit të gjendjes të përshkruar si më lartë, vetëm në bazë të deklaratave të tyre nuk mund të vërtetohet se të njëjtit me të vërtetë kanë votuar për kandidatin ankues, ashtu sikurse nuk mund të provohet nëse të njëjtit kanë votuar për ndonjë kandidat tjetër apo nëse vota e tyre është shpallur e pavlefshme, sepse vota është e fshehtë dhe nuk mund të identifikohet emri i votuesit në fletëvotim. Deklaratat e tyre mund të shërbejnë si provë për të urdhëruar hetimin e materialit zgjedhor për të vërtetuar me saktësi pretendimet ankimore por jo edhe për të vërtetuar se personat e caktuar vërtetë kanë votuar për kandidatin e caktuar.

Sipas nenit 117 [Procedurat e PZAP-së] par.3 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”* si dhe neni 13 [Vendimarrja e PZAP-it] të Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, ku përcaktohet se: *“PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*.

Ankuesi, me pretendimet ankimore, me asnjë provë nuk ka arritur që të vë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë nga ana e organit vendimi i të cilit është kontestuar, andaj si të pathemelta i ka vlerësuar pretendimet e ankuesit në ankesë, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.126/2025 me datë 03.12.2025

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi





REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLICA OF KOSOVA
KESHIMI I GJYQESOR E KOSOVES/ SUPREME COURT OF KOSOVO

SEKRETARATI I KESHIMIT GJYQESOR TE KOSOVES



Sheji i shkreses 17.12.25
Oznaka spjeg 3.12.2025

2248

PLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e kështë dësh të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkronjë për shkak të dorëzimit të gjendje në kohën e caktuar në bënësin apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë anëtarit mbarhor të familjes së marrësit - kujdesit të ndërsesë, i qit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Pasi pritënie, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ina izvrsti ni pošto ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stani radnom mestu, dostava je izvršena: odaslom članu domaćin. Primaoca naslojniku zgnac susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtarit i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresë u la në bënësin në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në dësh e bënësin ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posio pritilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stani - radnom mestu primaoca (pribicno na vralim stana odnosno prostorije gde pritilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
Shtaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijma

Nënshtkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Emri i shkresës
Naslov pisma koja se dostavlja:
1- Aktgledica i ok
3.12.2025
Numri i shkojave:
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdijeno prijem gorenavegengog pisma
(i slovima)

03.12.2025
(Nënshtkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili licn koje je
pismeno primilo u znanicu)
15.07
Nënshtkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshtkruajë dorëzuesi, duke shënnar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshtkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Pro 2008